

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR RIINTEGRIMIN E PERSONAVE TË RIATDHESUAR
NË KOSOVË



Prishtinë, Tetor 2013

Tabela e përmbajtjes	
Lista e shkurtesave	3
Kapitulli I - Përmbledhje Ekzekutive	4
Kapitulli II - Hyrje.....	5
Kapitulli III - Metodologjia	6
Kapitulli IV - Sfondi	7
IV.1. Migrimi	7
IV.2. Riatdhesimi dhe riintegrimi.....	8
IV.3. Analiza e situatës	10
IV.3.1. Çështjet e dokumenteve dhe certifikatave personale	11
IV.3.2. Sistemi shëndetësor.....	11
IV.3.3. Çështjet e banimit.....	11
IV.3.4. Qasja në arsim.....	12
Kapitulli V - Kuadri Strategjik	12
V.1. Vizioni	12
V.2. Deklarata e misionit	12
V.3. Objektivat.....	13
V.3.1. Objektivat strategjike	13
V.3.2. Objektivat specifike	13
Kapitulli VI - Alternativat e Shqyrtuara	13
Kapitulli VII. Korniza Ligjore dhe Institucionale	14
VII.1. Korniza ligjore	14
VII.2. Institucionet relevante.....	15
VII.2.1. Niveli qendror	15
VII.2.2. Niveli lokal.....	19
Kapitulli VIII - Implementimi	19
VIII.1. Programi për Riintegrim.....	20
VIII.1.1. Qëndrueshmëria dhe mobilizimi social	20
VIII.1.2. Decentralizimi i kompetencave	20
VIII.1.3. Aktivitetet dhe iniciativat.....	20
VIII.1.4. Mbështetja dhe ndihma	21
VIII.2. Fondi për Riintegrim.....	22
VIII.2.1. Mbulesa financiare	22
VIII.2.2. Menaxhimi i Fondit.....	22
VIII.2.3. Sistemi i Menaxhimit të Rasteve (SMR)	23
Kapitulli IX - Monitorimi dhe Vlerësimi.....	24
IX.1. Strukturat institucionale për monitorim dhe vlerësim	24
IX.2. Mekanizmat raportues.....	25
IX.3. Identifikimi i indikatorëve	25
IX.4. Shpërndarja e rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit.....	25
Kapitulli X. Ngritja e vetëdijes dhe fushatat e informimit	25
Shtojcat.....	26

Lista e shkurtesave

ANP	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës
BE	Bashkimi Evropian
DPPA	Deklarata e Politikave Prioritare Afatmesme
DRPR	Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar
DSHAM	Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
KA	Komisioni i Ankesave
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KKR	Komisioni Komunal për Riintegrim
KQR	Komisioni Qendror për Riintegrim
MAPL	Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MeD	Ministria e Diasporës
MF	Ministria e Financave
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
PPB	Politika e Përbashkët Bujqësore
PSO	Procedurat Standarde Operative
SMR	Sistemi i Menaxhimit të Rasteve
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNHCR	Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNICEF	Fondi i Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
ZKKK	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

Kapitulli I. Përmbledhje Ekzekutive

Politikat e Qeverisë së Republikës së Kosovës në fushën e migracionit dhe riintegrimin të personave të riatdhesuar, paraqesin një aspekt të rëndësishëm në marrëdhëniet e Republikës së Kosovës me shtetet anëtare të BE-së¹, në kuadër të angazhimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Qeveria) për liberalizimin e vizave dhe për antarësim në Bashkimin Evropian.

Strategjia Kombëtare për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, në tekstin e mëtejme referohet si Strategjia për Riintegrim, është dokument strategjik i cili përshkruan politikat dhe masat që duhen ndërmarrë për sigurimin e riintegrimin të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar, duke u përqendruar në mënyrë specifike në fushat kryesore të regjistrimit civil, shëndetësisë, arsimit, punësimit, mirëqenies sociale dhe banimit. Gjithashtu, ofron kornizën institucionale për menaxhimin e riintegrimin të personave të riatdhesuar, definon rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve qendrore dhe lokale në secilën fazë të procesit të riintegrimin në tërësi, si dhe përcakton procedurat dhe mekanizmat e bashkërendimit për të trajtuar nevojat dhe për të promovuar të drejtat e personave të riatdhesuar.

Për zbatimin e suksesshëm të Strategjisë për Riintegrim është hartuar Plani i Veprimit, në të cilin pasqyrohen të gjitha masat konkrete të veprimit për të gjitha institucionet e ngarkuara me zbatimin e saj. Plani i Veprimit përcakton aktivitetet e veçanta që duhen ndërmarrë nga institucionet përkatëse të nivelit qendror dhe lokal. Plani i Veprimit përmban objektivat e përgjithshëm dhe specifik, aktivitetet konkrete për arritjen e objektivave, përcakton institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për arritjen e secilit objektivi dhe aktivitet, saktëson kornizën kohore për realizimin e secilit aktivitet, përcakton koston e përafërt financiare për zhvillimin e aktiviteteve dhe indikatorët matës të objektivave dhe aktiviteteve.

Strategjia për Riintegrim synon të ndikojë dhe inkurajojë qytetarët dhe bizneset që të aplikojnë praktikatat që kontribuojnë në riintegrim të qëndrueshëm.

Synim i përgjithshëm i Strategjisë së Riintegrimin është fuqizimi i mekanizmave të strukturuar mirë, të pavarur, plotësisht funksional dhe profesional për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar, në nivelin qendror dhe lokal.

Për të arritur qëllimin e përgjithshëm, Qeveria do të:

- Hartoj dhe zbatoj kornizën ligjore gjithëpërfshirëse;
- Fuqizoj strukturat ekzistuese institucionale në nivelin qendror dhe lokal;
- Fuqizoj dhe zbatoj mekanizmat efektiv të koordinimit dhe bashkëpunimit horizontal dhe vertikal;
- Funkcionalizoj sistemin për Menaxhimin e Rasteve (SMR);
- Decentralizoj kompetencat dhe resurset në nivel lokal;
- Siguroj kapacitetet e burimeve njerëzore adekuate;
- Siguroj mjete të mjaftueshme dhe mekanizma funksional për shpërndarjen e tyre;
- Siguroj shmangien e diskriminimit pozitiv, ndërsa shërbime specifike ofrohen vetëm për kategori të caktuara në harmoni me legjislacionin në fuqi;
- Fuqizoj bashkëpunimin mes strukturave publike dhe shoqërisë civile për hartimin dhe zbatimin e programeve specifike në ndihmë të riintegrimin të personave të riatdhesuar;
- Ngrit vetëdijësimin përmes fushatave publike informuese;

¹SHA-të e BE-së kanë qene vend destinacion për shumicën e emigranteve nga Republika e Kosovës

- Siguroj trajtim të barabartë për të gjithë personat e riatdhesuar duke marrë parasysh nevojat e tyre specifike;
- Fuqizoj sistemin e monitorimit dhe raportimit.

Strategjia për Riintegrim është e strukturuar në dhjetë kapituj. Kapitulli i parë pasqyron përmbledhjen ekzekutive ku janë të përshkruara synimet e e Strategjisë për Riintegrim. Kapitulli i dytë paraqet ndërlidhjen e Strategjisë për Riintegrim me prioritetet e Qeverisë si dhe arsyet për inicimin e Strategjisë për Riintegrim. Kapitulli i tretë pasqyron bazat metodologjike të aplikuara gjatë hartimit të Strategjisë për Riintegrim. Kapitulli i katërt paraqet Sfondin - Migrimin, Riatdhesimin dhe Analizën e Situatës. Kapitulli i pestë paraqet Kuadrin Strategjik lidhur me -Vizionin, Misionin dhe Objektivat të cilat do të elaborohen në Planin e Veprimit me aktivitete specifike dhe indikatorë të matshëm për përmbushjen e tyre. Kapitulli i gjashtë paraqet alternativat e shqyrtuar në këtë dokument. Kapitulli i shtatë paraqet kornizën institucionet relevante. Kapitulli i tetë pasqyron Programin e Riintegrimin, fondin dhe sistemin për menaxhimin e rasteve (SMR). Kapitulli i nëntë paraqet monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit. Kapitulli i dhjetë elaboron fushatat e ndryshme të vetdijesimit. Në shtojcë janë paraqitur informatat shtesë lidhur me definicionet dhe legjislacionin nacional.

Strategjia për Riintegrim e njeh kontributin e donatorëve potencial dhe shoqërisë civile në Kosovë në ofrimin e shërbimeve të riintegrimin për personat e riatdhesuar dhe nxit bashkëpunimin e tyre me institucionet shtetërore për këtë qëllim.

Strategjia për Riintegrim do të zbatohet në periudhën 5 vjeçare brenda periudhës kohore (2013-2017), ndërsa Plani i Veprimit përfshinë aktivitete dhe koston e përafërt financiare për periudhën 3 vjeçare (2014 - 2016) me mundësi rishikimi dhe azhurnimi vjetor.

Kapitulli II. Hyrje

Strategjia për Riintegrim është në pajtim me prioritetet e përgjithshme të Qeverisë përfshirë edhe obligimet që dalin nga procesi i liberalizimit të vizave dhe obligimet tjera ndërkombëtare, si dhe siguron konsistencën mes tyre.

Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar për krijimin e kushteve relevante për riintegrimin e suksesshëm dhe të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe zbatimin e reformave të nevojshme në mënyrë që të plotësohen kriteret për riintegrim në Bashkimin Evropian.

Në Programin Qeverisës 2011-2014, Qeveria ka identifikuar si prioritet funksionalizimin e plotë të mekanizmit për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe garantimin e riintegrimin të qëndrueshëm të qytetarëve që kthehen në Kosovë. Procesin e riintegrimin është rikonfirmuar si prioritet edhe në Deklaratën e Politikave Prioritare Afatmesme (DPPA) 2014 - 2016 si dhe me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2014 - 2016.

Me pranimin e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave janë identifikuar nevojat për rishikimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Riintegrim. Qeveria e Republikës së Kosovës ka paraparë rishikimin dhe miratimin e këtyre dokumenteve në Planin Vjetor të Punës për vitin 2013 dhe Planin e Dokumenteve Strategjike 2013.

Plani i Veprimit për negociimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit ka identifikuar rishikimin e Strategjisë për Riintegrim. Strategjia për Riintegrim dhe Plani i Veprimit për 2013-2017 plotëson veprimin 6, të kriterit 3.62, të kësaj marrëveshjeje.

Strategjia për Riintegrim dhe Plani i Veprimit për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar përmbush edhe veprimin 9.1 të Planit të Veprimit për Zbatimin e Udhëzuesit për Liberalizimin e Vizave. Me hyrjen në fuqi të kësaj strategjie dhe me raportimet e rregullta (tre mujore) monitoruese për zbatimin e aktiviteteve, Republika e Kosovës përmbush një pjesë të rëndësishme të kriterëve në lidhje me riintegrimin.

Strategjia për Riintegrim mbulon të gjitha fazat e procesit të kthimit, që nga momenti i ripranimit deri te shpërndarja e asistencës në fusha të ndryshme dhe synon arritjen e riintegrimin të plotë të qëndrueshëm ligjor, politik, social dhe ekonomik. Të gjitha aktivitetet do të përshkruhen në detale në pjesën e mëtutjeshme të këtij dokumenti, por ato mund të kategorizohen në tri grupe kryesore me qëllim të preznatimit të fushëveprimit të *Strategjisë së Riintegrimit*:

- **Faza e ripranimit**, e menaxhuar nga Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion (DSHAM) i Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe nga Policia Kufitare;
- **Ndihma e ofruar në nivelin qendror**, e menaxhuar nga Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar (DRPR) e MPB-së më përfshirjen e ministrive të tjera;
- **Asistenca e ofruar në nivelin komunal**, e menaxhuar nga autoritetet lokale nën koordinimin e Zyreve Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) dhe nën mbikëqyrjen e përgjithshme të DRPR-së.

Kapitulli III. Metodologjia

Strategjia për Riintegrim pasqyron zhvillimet në procesin e riintegrimin dhe duke marrë parasysh mësimet e nxjerra gjatë procesit, boshllëqet dhe sfidat e identifikuar gjatë monitorimit, kriteret që dalin nga procesi i integrimi evropiane, inkorporon praktikat më të mira për procesin e riintegrimin.

Në hartimin e Strategjisë për Riintegrim dhe Planit të Veprimit janë konsultuar dokumentet e politikave Qeveritare në fushën e migracionit, akterët relevantë (shih Kapitullin VII) dhe palët e interesuara vendore dhe ndërkombëtare.

Gjatë hartimit të Strategjisë për Riintegrim janë adresuar të gjitha kërkesat nga Udhërfyesi për Liberalizimin e Vizave, rekomandimet e dala nga raporti i Komisionit Evropian i datës 8 shkurt 2013 për progresin e Kosovës, në plotësimin e kërkesave të dala nga Udhërfyesi për liberalizimin e vizave dhe Plani i Veprimit për negociimin e marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Qeveria e Republikës së Kosovës vlerëson kontributin e Komisionit Evropian, UNDP-se, UNHCR-it, OSBE-se, IOM-it, UNICEF-it dhe akterëve tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë për përkrahjen gjatë hartimit të kësaj strategjie.

Strategjia e Riintegrimin është hartuar duke u bazuar ndër të tjera në parimet në vijim:

Qëndrueshmëria: Të gjitha aktivitetet e planifikuara garantojnë riintegrim të qëndrueshëm dhe janë në përputhje me standardet zhvillimore ndërkombëtare dhe të planifikuara me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH).

Adresimi i sfidave: Analiza e rregullt e situatës e cila ka rezultuar me identifikimin e boshllëqeve dhe nevojave, adresohen në objektivat strategjik dhe specifik. Vëmendje e veçantë i është kushtuar ngritjes së kapaciteteve komunale në burime njerëzore dhe në pajisje teknike,

funksionalizimit të Sistemit për Menaxhimin e Rasteve, fuqizimit të bashkëpunimit dhe koordinimit me palët e tjera të interesit të përfshira, mbështetjes së theksuar të grupeve të cenueshme dhe decentralizimit të kompetencave administrative dhe resurseve.

Harmonizimi i asistencës dhe shmangia e diskriminimit pozitiv: Harmonizimi i asistencës konsiston në koordinimin e shërbimeve dhe mbështetjes nga programet e kthimit dhe riintegrimin të cilat ofrohen për personat e riatdhesuar nga donacionet dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, duke përfshirë shkëmbimin reciprok të të dhënave. Shmangia e diskriminimit pozitiv konsiston kryesisht në përmirësimin e informimit të personave të riatdhesuar mbi shërbimet publike ekzistuese tek të cilat kanë qasje të gjithë qytetarët kosovarë sipas legjislacionit në fuqi. Shërbime specifike ofrohen vetëm për grupe të cenueshme përmes projekteve/programeve specifike të hartuara dhe zbatuara me mbështetjen e donatorëve të ndryshëm.

Gjatë procesit të riintegrimin të personave të riatdhesuar vëmendje e posaçme do t'u kushtohet:

- Nënave vetë-ushqyese;
- Fëmijëve pa përkujdesje familjare dhe fëmijët e braktisur;
- Fëmijëve pa kujdes prindëror si dhe fëmijët e abuzuar dhe keqtrajtuar;
- Mbrojtjes së fëmijëve me nevoja të veçanta, me theks te veçant minoriteteve;
- Minoriteteve Rom, Ashkali, Egjiptian dhe minoriteteve tjera ne nivelin komunal;
- Personave të moshuar pa përkujdesje familjare;
- Personave me aftësi të kufizuara mendore dhe pa përkujdesje familjare;
- Familjeve me gjendje të rëndë ekonomike;
- Viktimave të trafikimit me qenie njerëzore.

Për viktimat e trafikimit do të aplikohen programe të veçanta në harmoni me legjislacionin në fuqi dhe Strategjinë Nacionale e Planin e Veprimit Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore 2011-2014. Po ashtu, vëmendje e posaçme do tu kushtohet komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, veçanërisht në mbështetjen dhe ndihmën për regjistrim civil, përfshirje në arsim dhe zgjedhjen e qështjes së banimit.

Fleksibiliteti dhe pjesëmarrja e përfituesit: Së bashku me standardizimin e hapave, aktiviteteve, procedurave dhe shërbimeve që janë të domosdoshme për një menaxhim efektiv dhe efikas të procesit të riintegrimin, një shkallë e lartë e fleksibilitetit do të adaptohet për dhënien e asistencës.

Përfshirja: Në procesin e riintegrimin do të përfshihen të gjithë personat e riatdhesuar pa dallim moshe, gjinie, përkatësisë etnike, fetare e racore. Ndihma dhe mbështetja nga programi i riintegrimin u ofrohet personave të riatdhesuar sipas kritereve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Kapitulli IV. Sfondi

IV.1. Migrimi

Trendet dhe shkaqet e migrimit nga Kosova kanë ndryshuar gjatë dekadave². Para viteve 1998/1999, kosovarët emigruan për arsye politike dhe socio-ekonomike, posaqërisht gjatë viteve të 90-ta. Gjatë luftës, përveç zhvendosjes së qytetarëve përbrenda territorit të Kosovës, qindra mijëra u detyruan të lëshojnë vendin. Fillimisht ata u larguan në shtetet fqinje, kryesisht në Shqipëri dhe Maqedoni. Shumica e tyre u kthyen pas përfundimit të luftës, megjithatë ka

² Shih studimin e UNDP Kosovë për Remitentat 2012 (http://ëëë.kosovo.undp.org/repository/docs/KRS2012_English_858929.pdf).

ende mira Kosovare të zhvendosur shtetet fqinje. Një numër i madh i tyre gjetën strehim edhe në vendet e Evropës Përendimore. Trendi i migrimit ka vazhduar dhe po vazhdon ende për arsye të ndryshme. Migrantët të cilët nuk kanë status legal të qëndrimit në vendet perëndimore duhet të riatdhesohen qoftë në mënyrë vullnetare apo të detyruar.

Qeveria e Republikës së Kosovës promovon migrimin legal me qëllim të lehtësimit të udhëtimit në shtetet anëtare të BE-së dhe përfitimin nga programet e migrimit qarkullues, që lehtëson qarkullimin e shtetasve ndërmjet Republikës së Kosovës me SHA të BE-së në mënyrë ligjore, duke përfshirë migrimin për qëllime studimi, punësimi sezonal, shkëmbim të eksperiencave, si dhe kurse të ndryshme trajnimi të ndryshme.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndërmarrë një sërë iniciativash me qëllim të administrimit të migracionit duke krijuar kornizën ligjore në fushën e migracionit në harmoni me legjislacionin e BE-së. Janë miratuar dokumente strategjike si: Strategjia Shtetërore për Migrim dhe Plani i Veprimit 2013-2018, Strategjia Shtetërore e Republikës së Kosovës Kundër Krimit të Organizuar dhe Plani i Veprimit 2012-2017, Strategjia Shtetërore e Republikës së Kosovës për Parandalimin e Krimit dhe Plani i Veprimit 2009-2012, Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit 2012-2017 dhe Strategjia Nacionale dhe Plani i Veprimit Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore 2011-2014.

IV.2. Riatdhesimi dhe Riintegrimi







Disa vite pas menaxhimit ndërkombëtar të procesit të kthimit nga UNMIK-u, nga viti 2008 përgjegjësia është bartë tek Qeveria e Republikës së Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndërtuar mekanizmat e nevojshëm ligjor dhe institucional për menaxhimin e suksesshëm të procesit të riatdhesimit dhe kthimit duke respektuar dinjitetin e qytetarëve me origjinë nga Kosova.

Gjatë periudhës 2010 dhe mesi i vitit 2013, janë kthyer 15.934 persona nga shtetet të ndryshme. Numri i personave të kthyer me forcë është më i madh krahasuar me numrin e personave të kthyer vullnetarë. Nga numri i përgjithshëm, 64% janë të ripranuar me forcë dhe 36% janë kthyer vullnetarisht. Vështuar sipas shteteve 17.6 % prej tyre janë kthyer nga Gjermania, 15.4 % nga Zvicra, 14.4 % nga Suedia, 10.9 % nga Austria, 9 % nga Belgjika, 8.4 % nga Franca, 8.3 % nga Hungaria, 3.8 % nga Norvegjia, 2.6% nga Finlanda, 1.4% nga Luksemburgu, 1.3% nga Kroacia, etj³. Numri më i madh i personave të ripranuar (vullnetarë dhe me forcë) janë nga komunat e Gjilanit, Mitrovicës dhe Prishtinës. Në bazë të grupmoshave personat e ripranuar janë kryesisht të moshave 18-34 vjeç ku dominon gjinia mashkullore. Sa i përket nacionalitetit personat e ripranuar janë kryesisht të nacionalitetit shqiptar, pasuar nga nacionaliteti rom, ashkali, egjiptas, serb etj.

³Raportet vjetore nga DSHAM

Të dhënat mbi profilin e personave të ripranuar të paraqitura për periudhën 2010, 2011, 2012 dhe gjashtë mujorin e parë të vitit 2013



Nevoja për mbështetjen e riintegritit ka lindur si rezultat i riadhesimit të një numri të madh të personave të cilët për një kohë të gjatë kanë jetuar jashtë Kosovës.

Procesi i riintegritit përbëhet nga ofrimi i ndihmës dhe mbështetjes së personave të riadhesuar në nivelin qendror dhe lokal, duke filluar që nga asistenca emergjente, qasja në shërbimet publike dhe të tjera, me qëllim që kthimi të jetë i qëndrueshëm. Gjatë vitit 2012 janë mbështetur 2945 të riadhesuar nga programi për riintegrim të cilët kanë qenë përfitues të skemave të ndryshme.

IV.3. Analiza e Situatës

Në dokument janë analizuar dhe identifikuar përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet gjatë trajtimit të riintegrimin.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe legjislacioni janë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe paraqesin kornizën ligjore që rregullon aspektet e jetës civile dhe politike të qytetarëve të Kosovës. Praktikata e bartura nga Institucionet Ndërkombëtare, të cilat për një kohë të gjatë kanë menaxhuar me procesin e riatdhesimit, kanë lehtësuar themelimin e mekanizmave dhe procedurave operacionale nga institucionet vendore.

Qeveria e Republikës së Kosovës që nga viti 2007 ka përgatitur dhe miratuar kornizën e politikave për riintegrimin e personave të riatdhesuar, ka miratuar Strategjinë, Planin e Veprimtari si dhe Rregulloren për Menaxhimin e Programit për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar. Në shtator 2010 Qeveria ka themeluar Fondin e Riintegrimin për mbështetjen e riintegrimin të qëndrueshëm të shtetasve kosovarë të riatdhesuar duke e dedikuar buxhetin në shumën prej 500,000 euro në vitin 2010, 3,420 150 euro në 2011, 3,170 150 euro për vitin 2012 dhe shumën e njëjtë e ka ndarë edhe për vitin 2013.

Organizatata ndërkombëtare janë ende aktive në ofrimin e asistencës teknike, këshillimit dhe konsulencës e që është një mbështetje për institucionet vendore. Megjithatë, numri i madh i personave të riatdhesuar që duhet riintegriar në shoqëri paraqet një sfidë të madhe për institucionet e Kosovës. Për këtë arsye duhet të fuqizohen kapacitetet ekzistuese në të gjitha aspektet. Sistemi shëndetësor, edukativo-arsimor dhe social kanë nevojë për ngritje të kapaciteteve me qëllim të ngritjes së standardeve të cilësisë në lidhje me shëndetësinë, regjistrimin e fëmijëve në shkolla, ofrimin e mësimin plotësues, kyqjen në skema sociale, aftësimin profesional, punësimin.

Po ashtu procesi i riintegrimin të personave të riatdhesuar kërkon kosto të lartë financiare e që është një sfidë shtesë për Qeverinë e Republikës së Kosovës. Ndihma dhe mbështetja e ofruar për personat e riatdhesuar përveq shërbimeve themelore përfshinë edhe strehimin, banimin, rindertimin/renovimin e shtëpive të cilat janë shkatërruar/dëmtuar, financimin e projekteve për gjenerimin e të hyrave vetanake dhe lloje tjera tjera të ndihmës dhe mbështetjes.

Personat e riatdhesuar kanë vështirësi që brenda një periudhe të shkurtë kohore të gjenerojnë të hyra, gjë që rezulton në rritjen e numrit të personave të varur nga skemat sociale që e rëndojnë edhe mëtej buxhetin e Kosovës. Për të pasur një proces të sukseshëm të riintegrimin të personave të riatdhesuar është me rëndësi të krijohen mundësitë për kurse të aftësimeve profesionale, mundësive për punësim apo fillimi i veprimtarive profitabile për gjenerim të të ardhurave përmes zhvillimit të planeve të biznesit.

Në procesin e riintegrimin janë të përfshirë shumë akterë të nivelit qendror dhe lokal. Për të ofruar shërbime në mënyrë efikase dhe efektive koordinimi dhe bashkëpunimi reciprok ndërmjet akterëve të kyqur në procesin e riintegrimin është i domosdoshëm duke përfshirë edhe Organizatat Ndërkombëtare dhe Shoqërinë Civile.

Fuqizimi i kapaciteteve, mekanizmave koordinues horizontal dhe vertikal, sistemit të monitorimit dhe raportimit, me theks të veçantë në funksionalizimin e sistemit për menaxhimin e rasteve, paraqesin ende sfida që në këtë strategji i është kushtuar vëmendje e posaqme.

Personat e riatdhesuar mund të sjellin me vetë aftësi dhe resurse që ata i kanë fituar gjatë kohës së qëndrimit në vendet e zhvilluara dhe mund t'i aplikojnë/investojnë ato. Është e domosdoshme të ndërtohen këto kapacitete për të ruajtur çfarëdo dobie që është bërë dhe shndërrimin e tyre në faktorë shtytës për zhvillimin e përgjithshëm të Kosovës.

Megjithatë të riatdhesuarit në të shumtën e rasteve ballafaqohen me sfida të cilat e vështirësojnë riintegrimin e qëndrueshëm të tyre. Personat e riatdhesuar, në të shumtën e rasteve rifillojnë jetën me pak resurse të veta, apo të mvarur plotësisht nga skemat sociale. Prandaj sigurimi i burimit (gjenerimit) të të hyrave vetanake për personat e riatdhesuar është i rëndësishëm për riintegrimin e qëndrueshëm të tyre.

Pavarësisht nga rritja ekonomike që është arritur gjatë viteve të fundit, vendi ende ballafaqohet me sfida të shumta, me një shkallë të papunësisë prej 35.1%, inflacioni mbi 2.5% shkallë e ulët e eksportit, sektor privat ende të dobët dhe investime të kufizuara të huaja.⁴

IV.3.1. Çështjet e dokumenteve dhe certifikatave personale

Shtetasit e Kosovës mund të aplikojnë për tu pajisur me dokumente të gjendjes civile, dokument identifikimi (letërnjoftim) dhe pasaportë të Republikës së Kosovës, në harmoni me legjislacionin në fuqi. Posedimi i dokumenteve personale të cilat vërtetojnë identitetin e personit është me rëndësi esenciale në mënyrë që ata të kenë qasje në shërbimet publike dhe të gëzojnë të drejtat civile dhe politike. Mungesa e dëshmisë së identitetit nënkupton pamundësi qasjeje në nënshtetësi dhe *de facto* mungesë shtetësie, pamundësi qasjeje në skemat sociale, kujdesin shëndetësor, arsimim dhe mundësi punësimi. Të riatdhesuarit ballafaqohen me shumë pengesa sa i përket kësaj çështjeje. Mungesa e dokumentacionit bazë për pajisje me dokumente personale shpeshherë paraqet sfida serioze për riintegrim të qëndrueshëm.

IV.3.2. Sistemi shëndetësor

Personave të riatdhesuar u ofrohet asistencë mjekësore në shërbimin e kujdesit parësor, dytësor dhe tretësor, si gjithë shtetasve të tjerë të Republikës së Kosovës.

Sistemi shëndetësor i Kosovës paraqet sfida për një numër të shërbimeve të kujdesit tretësor (kardio-kirurgjike, onkologjike, poli-traumatologjike, transplante, çrregullimet mendore serioze). Personat e riatdhesuar që vuajnë nga sëmundjet serioze, të cilat janë trajtuar në vendet kthyesë, nuk marrin të njëjtin tretman pas kthimit.

Në krahasim me qytetarët tjerë të Kosovës, personat e kthyr gjenden në një situatë me të vështirë, përderisa ata mund të mos jenë në gjendje të kenë qasje për përkujdesje mjekësore pa pagesë për shkak të problemeve me dokumentacionet e nevojshme.

IV.3.3. Çështetja e banimit

Banimi është e drejtë sociale e qytetarëve në shumicën e vendeve të zhvilluara sepse është vendimtar për shëndet dhe zhvillim kualitativ të jetesës. E drejta për banim gjithnjë e më shumë është prezent në kuadër të politikave globale dhe në luftë për të drejtat njerëzore, e sanksionuar edhe me koneventat ndërkombëtare.

⁴ Agjensia e Statistikave të Kosovës, www.ks-gov.net

Në Kosovë pas luftës numri i shtëpive të dëmtuara ka qenë 120.000 ku 45.000 prej tyre janë vlerësuar si tërësisht të dëmtuara. Nga donatorët ndërkombëtarë janë rindërtuar rreth 60.000 shtëpi deri në vitin 2002. Gjithashtu, institucionet qendrore dhe lokale kanë realizuar projekte për rindërtimin e shtëpive dhe ndërtimin e objekteve të banimit me qira, mirëpo kërkesat e regjistruara në komuna për gjendjen e banimit ende janë të mëdha si rezultat i një numri të konsiderueshëm të shtëpive të shkatërruara, rasteve të shumta sociale, migrimit të brendshëm, ndryshimit të strukturës familjare dhe çmimeve të larta të shitblerjes së patundshmërisë.

Komunat, sigurimin e strehimit e bëjnë përmes programeve tre vjeçare të banimit për banesa me qira ku përfshihen banesat e ndërtuara nga komunat, qeveria dhe donatorët. Bazuar në gjendjen aktuale të personave të riatdhesuar në shumicën e rasteve kërkojnë strehim emergjent/të përkohshëm dhe ofrim të banimit me qira (bonus banimi) nga Fondi i Riintegrimit, sfidë edhe më tutje mbetet banimi i qëndrueshëm si pasojë e mungesës së kapaciteteve në nivel lokal.

IV.3.4. Qasja në arsim

Të gjithë qytetarët e Kosovës kanë të drejtë të qasjes në sistemin arsimor në harmoni me legjislacionin në fuqi. Shumë persona të kthyer kanë kaluar periudhë të gjatë kohore jashtë vendit, madje disa prej tyre janë lindur dhe arsimuar në vendet prej nga kthehen. Për të rinjtë, posaçërisht për fëmijët, kjo nënkupton që ata shpesh nuk kanë njohuri të ndonjërës nga gjuhët zyrtare në Kosovë (shqipe apo serbe), e që rezultojnë me vështirësitë për qasje në arsimim, trajnim dhe punësim pas kthimit. Qasja në asistencën sociale dhe mjekësore, e po ashtu edhe në shërbimet që ofrohen nga zyret publike, është e vështirësuar për ata të cilët nuk mund të komunikojnë në ndonjërin nga gjuhët zyrtare. Po ashtu është problematike edhe mungesa e dokumenteve (certifikatave/diplomave) për të dëshmuar nivelin e edukimit në vendet nikoqire.

Në procesin e riintegrimit të personave të riatdhesuar procesi edukativo-arsimor është i një rëndësie të posaqme. Me të kthyerit do të jetë edhe një numër i madh i fëmijëve dhe të rinjëve të cilët duhet të vazhdojnë shkollimin. MASHT duhet të jetë i gatshëm të pranojë dhe sistematizojë të gjithë nxënësit e të gjithave komuniteteve në të gjitha nivelet e arsimit shkollor, në harmoni me legjislacionin në fuqi. MASHT në mënyrë të veçantë do t'i përkushtohet arsimit të obliguar ku fillimisht nxënësit do të regjistrohen përmes procedurave jo formale.

Kapitulli V. Kuadri Strategjik

Qeveria e Kosovës është e përkushtuar në ndërtimin e një shteti demokratik, me prosperitet, të sigurtë dhe modern drejt arritjes së standardeve dhe progresit përendimor. Duke i dhënë rëndësi procesit të riatdhesimit në kuptim të ndikimit në jetën socio-ekonomike, riintegrimi i personave të riatdhesuar është një ndër prioritetet në agjendën politike.

V.1. Vizioni

Vizioni i Strategjisë së Riintegrimit është riintegrimi i suksesshëm dhe i qëndrueshëm për të riatdhesuarit, pavarësisht formës së kthimit, përmes ndihmës dhe mbështetjes gjatë tërë procesit të riintegrimit.

V.2. Deklarata e Misionit

Misioni i Startegjisë së Riintegrimit është krijimi i kushteve për riintegrim të qëndrueshëm përmes krijimit të mekanizmave plotësisht funksional dhe profesional për riintegrimin e

suksesshëm dhe të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar, dhe për garantimin e integritit të plotë socio-ekonomik të qytetarëve që kthehen në Kosovë.

V.3. Objektivat

Me objektivat strategjike do të përcaktohet mënyra e veçantë e veprimeve në arritjen e rezultateve të parapara dhe sensibilizimin e institucioneve dhe mekanizmave institucional në fushën e Riintegrimin të Personave të Riatdhesuar. Të gjithë objektivat përmbajnë në vete kornizën ligjore në fushën e migrimit, ripranimit, riatdhesimit dhe riintegrimin të qëndrueshëm dhe janë në përputhje me marrëveshjet bilaterale për ripranim, konventat ndërkombëtare dhe Acquis-in e BE-së.

V.3.1. Objektivat strategjikë janë:

1. Fuqizimi i kapaciteteve institucionale, instalimi i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit dhe decentralizimi i kompetencave.
2. Hartimi dhe zbatimi i politikave gjithëpërfshirëse në nivelin lokal me qëllim të arritjes së riintegrimin të qëndrueshëm.
3. Vetëdijësimi publik dhe mobilizimi social.

V.3.2. Objektivat specifike janë:

- 1. Fuqizimi i kapaciteteve institucionale, instalimi i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit dhe decentralizimi i kompetencave**
 - 1.1 Fuqizimi i kapaciteteve institucionale dhe burimeve njerëzore;
 - 1.2 Funksionalizimi i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit (SMR);
 - 1.3 Fuqizimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet akterëve relevantë të përfshirë në proces të riintegrimin;
 - 1.4 Fuqizimi i komunikimit - shkëmbimi i informatave para dhe pas arritjes;
 - 1.5 Decentralizimi i kompetencave administrative dhe resurseve.
- 2. Hartimi dhe zbatimi i politikave gjithëpërfshirëse në nivelin lokal me qëllim të arritjes së riintegrimin të qëndrueshëm**
 - 2.1 Zhvillimi i politikave të riintegrimin në nivel lokal;
 - 2.2 Ofrimi i shërbimeve të garantuara;
 - 2.3 Mbështetja socio-ekonomike për riintegrim të qëndrueshëm.
- 3. Vetëdijësimi publik dhe mobilizimi social**
 - 3.1 Informimi i personeve të riatdhesuar për mundësitë e përfitimit;
 - 3.2 Organizimi i fushatave për vetëdijësim publik;
 - 3.3 Përfshirje e shoqërisë civile në implementimin e projekteve për mobilizim të qëndrueshëm social.

Kapitulli VI. Alternativat e Shqyrtuara

Objektivat strategjikë kanë për qëllim riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në shoqërinë kosovare, duke garantuar trajtim të barabartë të tyre. Strategjia për Riintegrimin trajton të gjitha çështjet me rëndësi në mënyrë të barabartë për të riatdhesuarit, në fokus të veçantë, kujdesin primar për jetën e tyre.

Strategjia për Riintegrim ofron alternativa të mjaftueshme dhe të qëndrueshme në trajtimin e problemeve të riatdhesuarve, që mundësojnë integrimin të sërishëm në jetën shoqërore e ekonomike.

Ngritja e të drejtave të riatdhesuarve në nivele të prioriteteve shtetërore tregon qartë angazhimin e institucioneve për mbështetjen e personave të riatdhesuar gjatë procesit të riintegrimit, gjë që kjo strategji e trajton në mënyrë adekuate procesin e riintegrimit të të riatdhesuarve në vendin tonë.

Alternativat e prezantuara në Strategjinë për Riintegrim përmes objektivave dhe nën objektivave, do të ndikojnë në jetën e të riatdhesuarve në periudhën vijuese duke stimuluar ata të bashkëpunojnë me të gjithë akterët për riintegrim më të lehtë dhe të qëndrueshëm të tyre.

Përmes Strategjisë së Riintegrimit dhe Planit të Veprimit, synohet që brenda periudhës 5 vjeçare, dhe në vijim sipas nevojës, të përmirësohet gjendja e të riatdhesuarve përmes aktiviteteve që do të ndërmerren. Alternativat e konsideruara përmes kësaj Strategjie për Riintegrim, gjithashtu sjellin mundësi objektive për përmirësimin e gjendjes së të riatdhesuarve dhe përmes kësaj të kenë ndikim pozitiv me kontributin e tyre për zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të vendit.

Kapitulli VII. Korniza Ligjore dhe Institucionale

VII. 1. Korniza Ligjore

Procedurat e Ripranimit rregullohen me Ligjin për Ripranim dhe marrëveshjet bilaterale të ripranimit të nënshkruara me SHA-të e BE-së dhe vendet tjera. Ligji për Ripranim zbatohet ndaj të gjitha vendeve me të cilat Republika e Kosovës nuk ka nënshkruar marrëveshje bilaterale për ripranim. Ligji i Ripranimit është në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi dhe Acquis-in e BE-së.

Kosova është në proces të nënshkrimit të marrëveshjeve bilaterale të ripranimit me vendet e BE-së dhe vendeve tjera. Marrëveshje të tilla deri më tani (Shtator 2013) janë nënshkruar me 21 shtete, përfshirë me 16 shtete anëtare të BE-së, tri shtete anëtare të Schengenit dhe dy shtete të Ballkanit përendimor⁵. Me tri shtete të tjera marrëveshje të tilla janë në proces të negocimit⁶, me gjashtë shtete janë dërguar nisma përmes MPJ-së, në të cilin rast pritet përgjigje nga shtetet përkatëse⁷.

Marrëveshjet ekzistuese obligojnë palët kontraktuese të ripranojnë qytetarët e njëri tjetrit të cilët më nuk i plotësojnë, ose nuk i plotësojnë më tej kushtet në fuqi për hyrje ose qëndrim. Ata poashtu specifikojnë formularët që duhet të plotësohen për aplikacionet për ripranim dhe përmbajtjen e dispozitave për afatet kohore për kërkesa, koston e ripranimit, mbrojtjen e të dhënave, dëshminë e identitetit, dëshminë e hyrjes dhe transitit.

⁵Austria, shtetet e BENELUX-it (me marrëveshje të përbashkët), Bullgaria, Republika Çeke, Danimarka, Finlanda, Franca, Gjermania, Hungaria, Malta, Sllovenia, Suedia, Estonia, Kroacia, Norvegjia, Zvicrra, Principata e Lichtenstein-it, Shqipëria dhe Mali i Zi.

⁶Letonia, Italia dhe Maqedonia

⁷Irlanda, Lituania, Polonia, Portugalia, Mbretëria e Bashkuar dhe Turqia.

Procedurat e riintegritit si dhe mbështetja dhe ndihma e të riatdhesuarve gjatë procesit të riintegritit rregullohen me Rregulloren për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Menaxhimin e Programit.

Duke iu referuar ligjeve të aplikueshme në fushën e riatdhesimit dhe riintegritit, të gjithë personat e kthyer që bijnë nën fushëveprimin e *Strategjisë së Riintegritit*, duhet të gëzojnë tretman të barabartë me pjesën tjetër të qytetarëve të Kosovës e që ndërlidhet me të drejtat dhe detyrimet që nuk janë specifike për procesin e kthimit.

Legjislacioni relevant për procesin e ripranimit dhe riintegritit janë dhënë në shtojcën B.

VII.2. Institucionet Relevante

Përmes autoriteteve qendrore dhe lokale të përshkruara në këtë kapitull, Qeveria e Republikës së Kosovës do të zbatojë *Strategjinë e Riintegritit*.

VII.2.1. Niveli qendror

Ministritë e përfshira në procesin e riintegritit në nivelin qendror janë si në vijim:

1. Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)

MPB-ja është përgjegjëse për hartimin e politikave të riintegritit në bashkëpunim të ngushtë me ministritë tjera të linjës. MPB është përgjegjëse për:

- Zhvillimin e përgjithshëm të politikave, planifikimin dhe orientimin e riintegritit të personave të riatdhesuar;
- Përcaktimin e masave legislative dhe buxhetore për mbështetjen e riintegritit;
- Vlerësimin dhe monitorimin e zbatimit të *Strategjisë për Riintegrim*;
- Informimin e ministrive relevante për gjendjen dhe nevojat e riintegritit të personave të riatdhesuar.

Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar (DRPR)

DRPR funksionon në kuadër të MPB-së dhe është organ përgjegjës për menaxhimin e riintegritit e personave të riatdhesuar.

DRPR është përgjegjës për:

- Hartimin e politikave dhe legjislacionit të riintegritit dhe monitorimin e zbatimit të tyre;
- Përgatitjen e udhëzuesve për procedurat e riintegritit, si dhe të përgatis dhe lëshoj udhëzime për autoritetet lokale;
- Monitorimin e zbatimit të programit për riintegrim;
- Krijimin e mekanizmave efikas për mbledhjen, raportimin dhe shpërndarjen e informatave ndërmjet administratës qendrore dhe lokale;
- Përgatitjen dhe shpërndarjen e materialeve informuese për komunat dhe personat e riatdhesuar;
- Përgatitjen e planit të përgjithshëm të trajnimeve për autoritetet komunale në fushën e riintegritit;
- Bashkëpunimin dhe koordinimin me organizatat vendore dhe ndërkombëtare lidhur me riintegrimin e personave të riatdhesuar;
- Mirëmbajtjen dhe avancimin e sistemit për menaxhimin e rasteve (SMR);
- Shqyrtimin e kërkesave nën kompetencën e nivelit qendror.

Përmes zyrtarëve të vendosur në Zyrën Pritëse në ANP organizohet pritja e personave të riatdhesuar ne te gjitha pikat e kalimit kufitar, informohen për mundësitë e përfitimit, identifikohen nevojat emergjente dhe sigurohen shërbimet e transportit në rast nevoje. Poashtu përmes koordinatorëve rajonal koordinon procesin e riintegrimin në mes të nivelit qendror dhe lokal dhe bën verifikimin e rasteve në teren në bashkëpunim me komunat përkatëse.

Qendra për Strehim të Përkohshëm

Qendra për Strehim të Përkohshëm menaxhohet nga DRPR dhe shërben për strehimin e personave të riatdhesuar deri në shtatë ditë, dhe siguron shërbimet tjera elementare si ushqim dhe trajtim mjekësor në rast nevoje.

Komisioni Qendror për Riintegrim (KQR)

KQR është organ vendimmarrës në nivelin qendror i cili përbëhet prej përfaqësuesve të MPB, MPMS, MMPH, MSH, MBPZHR dhe vendos për kërkesat e personave të riatdhesuar për përfitim nga Programi i Riintegrimin.

Komisioni për Ankesa

Komisioni për Ankesa shqyrton dhe vendos lidhur me ankesat e personave të riatdhesuar ndaj vendimeve të KQR-së dhe KKR-së.

2. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)

Misioni i MPMS-së është fuqizimi dhe krijimi i hapësirës për mirëqenie sociale, përfshirja në programet e punësimit dhe aftësimin profesional, për të gjithë qytetarët në gjendje të nevojës sociale. Në fushën e punësimit përgjegjësitë e MPMS-së përfshijnë formulimin dhe implementimin e politikave aktive dhe atyre pasive të tregut të punës, të cilat krijojnë qasje në tregun e punës, lehtësojnë tranzicionin në tregun e punës, kontribuojnë që më mirë të përshatet kërkesa me ofertën dhe ndihmojnë riintegrimin e grupeve të cënueshme.

Shërbimet e punësimit dhe aftësimin profesional menaxhohen nga Departamenti i Punës dhe Punësimit, ndërsa zbatohen përmes Zyrave të Punësimit dhe Qendrave të Aftësimin Profesional. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale gjithashtu është institucioni në nivelin qendror të qeverisjes, që trajton të gjitha çështjet lidhur me politikave sociale dhe të skemave pensionale. Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjes dhe Departamenti i Pensioneve, janë përgjegjëse për çështjet e politikave sociale dhe të pensioneve. Në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare rol vendimtar kanë Qendrat për Punë Sociale të monitoruara nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale si pjesë e përgjegjësiive vetanake të komunave.

Bazuar në programet që ka ministria dhe obligimet e dala nga Rregullorja për Riintegrimin dhe Riatdhesimin e Përsoneve të Riatdhesuar MPMS do të ofrojë këto shërbime:

- Mbështetjen dhe krijimin e mundësive për qasje në tregun e punës, përmes politikave aktive dhe pasive të tregut të punës;
- Ofrimin e trajnimeve profesionale të personave të riatdhesuar, më qëllim të aftësimin për tregun e punës;
- Ofrimin e ndihmave sociale dhe pagesave nga skemat pensionale, për të gjithë ata që i plotësojnë kërkesat sipas legjislacionit në fuqi;
- Ofrimi i shërbimeve për fëmijët dhe mbrojtja e tyre sipas formave të mbrojtjes, përmes Qendrave për Punë Sociale dhe angazhimin të OJQ-ve në ofrimin e shërbimeve;
- Ofrimi i shërbimeve për strehimin e viktimave të trafikimit dhe dhunës në familje, përmes Qendrave për Punë Sociale dhe OJQ-vë të kontraktuara;

- Ofrimi i shërbimeve për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar fizike dhe me lëndime të lehta mendore.

MPMS është përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të këtyre shërbimeve në procesin e riintegritimit dhe do të raportojë për progresin dhe sfidat në zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit.

3. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor përmes Departamentit të Banimit dhe Ndërtimit harton kornizën ligjore, institucionale dhe financiare që do të mundësojnë qasje të barabartë për të gjithë qytetarët për banim të përshatshëm, duke u bazuar në mundësitë e tyre financiare dhe statusin e tyre social dhe shëndetësor.

Politikat e banimit ofrojnë kushte të banimit të qëndrueshëm për familjet ose individët të cilët nuk janë në gjendje ekonomike t'i përmballojnë ofertat e tregut të lirë të banesave, si dhe caktimi i mënyrës së sigurimit dhe shfrytëzimit të mjeteve financiare për zhvillimin e programeve të veçanta të banimit në komuna.

Sigurimi i banimit me qira përmes programeve të përcaktuara me ligj:

- banim me qira joprofitabile dhe
- banim me qira bonus banimi.

Kjo do të realizohet përmes banesave të ndërtuara nga komuna, qeveria, banesat ekzistuese në pronësi të personave fizik apo juridik, të cilat jepen me qira, banesat tjera në pronësi të komunës, që mund të adaptohen për shfrytëzim në bazë të programeve të veçanta për banim.

4. Ministria e Shëndetësisë (MSH)

Ministria e Shëndetësisë ka për qëllim sigurimin e bazës ligjore për ruajtjen dhe përparimin e shëndetit të qytetarëve të Republikës së Kosovës nëpërmjet promovimit të shëndetit, aktiviteteve parandaluese dhe ofrimit të shërbimeve gjithpërfshirëse dhe kualiteteve të kujdesit shëndetësor. Ministria e Shëndetësisë përpilon politika dhe zbaton ligjet e një sistemi jo-diskriminues dhe të përgjegjshëm për kujdesin shëndetësor.

Kujdesi shëndetësor organizohet dhe zbatohet në tri nivele: parësorë, dytësorë dhe tretësorë. Komunitat janë përgjegjëse për Kujdesin Parësorë Shëndetësorë dhe për vlerësimin e gjendjes shëndetësore në territorin e tyre. Kujdesin Parësorë Shëndetësorë sigurohet dhe zbatohet brenda kornizës së shërbimeve të Mjekësisë Familjare, në pajtim me aktin nënligjor të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë. Në bazë të Ligjit të Shëndetësisë personat e riatdhesuar janë të liruar nga bashkëpagesat në vitin e parë pas riatdhesimit.

5. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)

MASHT ka mandat të veçantë dhe përgjegjësinë për sigurimin e kushteve themelore për arsimimin dhe edukimin e të riatdhesuarëve. Është obligim i MASHT-it, komunave, institucioneve arsimore dhe të gjitha organeve tjera të përfshira në ofrimin e arsimit parauniversitar për tu ofruar të gjithë fëmijëve të drejta të barabarta për shkollim në pajtim me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike.

Në procesin e riintegritimit të personave të riatdhesuar procesi edukativo-arsimor është i një rëndësie të posaqme. Me të kthyerit do të jetë edhe një numër i madh i fëmijëve dhe të rinjve të cilët duhet të vazhdojnë shkollimin. MASHT-ti duhet të jetë i gatshëm të pranojë dhe

sistematizoj të gjithë nxënësit e të gjithave komuniteteve në të gjitha nivelet e arsimit shkollor, në harmoni me legjislacionin në fuqi.

MASHT - ti në mënyrë të veçantë do t'i përkushtohet arsimit të obliguar ku fillimisht nxënësit do të regjistrohen përmes procedurave jo formale. Në këtë drejtim MASHT-ti do të përpiloj broshura për riintegrimin në procesin arsimor për personat e riatdhesuar, në lidhje me mundësitë me të gjitha shërbimet që janë në dispozicion, në mënyrë që nxënësit të kenë sa më lehtë regjistrimin në institucionet shkollore.

6. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL)

Ndihmon në hartimin e politikave dhe përcakton objektivat për zbatimin e kësaj strategjie, po ashtu siguron informata nga komunat për përditësimin e materialeve për riintegrim. MAPL-ja në bashkëpunim me ministritë e linjes ndihmon në hartimin e planeve të trajnimit dhe organizimit të tyre në nivelin lokal për riintegrimin e personave të riatdhesuar.

7. Ministria e Diasporës (MeD)

Në kuadër të fushëveprimtarisë së saj MeD harton dhe zbaton politikat dhe projektet që lidhen me diasporën. Në fushën e ripranimit dhe riintegrimit MeD shërben si urë lidhëse dhe komunikuese mes pjestarëve të mërgatës dhe institucioneve të Republikës së Kosovës.

8. Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK)

Komponenta kryesore e MKK-së, është riintegrimi i personave me origjinë nga Kosova të zhvendosur në territorin e ish Jugosllavisë dhe brenda për brenda Kosovës. Në procesin e Riintegrimit të Personave të Riatdhesuar. Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK), bashkëpunon me Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) dhe me ministritë e tjera të linjes. MKK mban statistikën për personat e zhvendosur që janë persona të cilët ishin banorë të përhershëm të Kosovës dhe ishin të zhvendosur brenda rajonit (Serbi, Mali i Zi, Maqedoni, Bosnjë dhe Hercegovinë) ose brenda Kosovës, si rezultat i luftës 1998-1999. MKK-ja mban informata për kuadrot institucional, procedurat e ripranimit dhe riintegrimit, procedurat për asistencën e të zhvendosurve si dhe bashkëpunimin me akterë të tjerë.

9. Ministria e Financave (MF)

Ministria e Financave është institucion përgjegjës që të siguroj rritjen e të hyrave buxhetore, monitorimin, menaxhimin e përgjithshëm financiar të drejtë dhe transparent të fondeve publike, ka role kyçe në përcaktimin dhe implementimin e politikave financiare dhe fiskale të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

10. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR)

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural harton dhe zbaton politikat agro-rurale për të ofruar mundësi punësimi, si dhe krijimin e të ardhurave për banorët që jetojnë në zonat rurale. MBPZhR jep kontribut të rëndësishëm për krijimin e një ambienti të përshtatshëm për zhvillimin rural dhe bujqësor duke mbështetur drejtëpërdrejtë fermerët, industrinë agro-përpunuese, infrastrukturën e ujitjes dhe grupeve lokale rurale. Gjithashtu, përfitues të këtyre politikave janë edhe personat e riatdhesuar që banojnë në zonat rurale. Ministria bën përafrimin e politikave nacionale me Politikën e Përbashkët Bujqësore (PPB) të BE-së, për implementimin e këtyre politikave ka themeluar strukturat administrative siç janë: Agjencia për Zhvillim të Bujqësisë, Departamenti për Politika Bujqësore (Autoriteti Menaxhues), Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve, Departamenti i Shërbimeve Këshilluese, Departamenti për Analiza Ekonomike dhe Statistika Bujqësore.

VII.2.2. Niveli lokal

Në nivelin lokal përfitimet dhe ndihma për mbështetjen e riintegrit kryesisht organizohen si pjesë e shërbimeve komunale dhe shërbimeve të tjera lokale në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me autoritetet lokale të mirëqenies sociale, shëndetësisë, punësimit, arsimimit, banimit dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve. Secila komunë do të ketë Zyrën Komunale për Kthim dhe Komunitete (ZKKK) dhe Komisionin Komunal për Riintegrim (KKR), në bazë të kompetencave të përcaktuara në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

(1). Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK)

Në nivelin lokal, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) është organi kryesor për riintegrimin e personave të riatdhesuar. ZKKK në procesin e riintegrit të personave të riatdhesuar i ka përgjegjësitë:

- Të informojë, ndihmojë dhe këshillojë personat e riatdhesuar për mundësitë dhe kriteret e përfitimit nga Programi për Riintegrim dhe për plotësimin e kërkesave;
- Të pranojë dhe identifikojë kërkesat e personave të riatdhesuar;
- Të vlerësojë nevojat preliminare dhe të procedojë kërkesat tek KKR ose tek DRPR për vendimmarrje;
- Të zbatojë bashkë me akterët e tjerë vendimet e KKR-së dhe KQR-së;
- Të mbështesë dhe monitoroj gjendjen e personave të riatdhesuar në koordinim me koordinatorët rajonal;
- Të bashkëpunojë me koordinatorët rajonalë dhe akterët e tjerë lokal;
- Të informojë personat e riatdhesuar për shërbimet që ofrohen nga Zyra për Punësim dhe zyrat e tjera komunale dhe të drejtojë personat në zyra për mbështetje dhe ndihmë të mëtejshme;
- Të mbledhë dhe regjistrojë informatat në bazën e të dhënave;
- Të raportojë në baza të rregullta tek kryetari i komunës dhe tek **Komisioni** Komunal për rrethanat e komunës në çështjet e riintegrit.

(2). Komisioni Komunal për Riintegrim (KKR)

Komisioni Komunal për Riintegrim merr vendime për kërkesat e personave të riatdhesuar për përfitime emergjente. KKR vlerëson nevojat relevante të personave të riatdhesuar lidhur me qasjen në regjistrat e gjendjes civile, pajisjen me dokumentet civile, arsimimin dhe regjistrimin në shkollë, trajtimin psiko-social në rast nevoje dhe ndihmën sociale, banimin dhe rregullimin e dokumenteve kadastrale.

(3) Drejtoritë komunale

Drejtoritë komunale, brenda territorit të komunës përkatëse, janë përgjegjëse që brenda kompetencave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi të ofrojnë ndihmë dhe mbështetje për personat e riatdhesuar gjatë procesit të riintegrit.

Kapitulli VIII - Implementimi

Duke u mbështetur në programet ekzistuese qeveritare dhe vizionin për të përmirësuar jetët e qytetarëve të Kosovës në aspektin e qëndrueshmërisë dhe të sigurisë si qëllim i zhvillimit të mëtejshëm ekonomik dhe shoqëror, Qeveria prezanton programin e riintegrit për mbështetjen e personave të riatdhesuar gjatë riintegrit të tyre në shoqërinë e Kosovës. Nëpërmjet prezantimit të Programit të Riintegrit, Qeveria synon angazhimin e përbashkët si një nga treguesit kryesor për zhvillimin e përgjithshëm të qëndrueshëm të vendit.

Procesit të ripranimit i nënshtrohen personat të cilët nuk i plotësojnë ose nuk i plotësojnë më tej kushtet për hyrje ose qëndrim në territorin e shtetit kërkues/kthyes, dhe si rezultat i kësaj riatdhesohen në Kosovë.

Procesi i riintegritit përbëhet nga ndihma dhe mbështetja e personave të riatdhesuar në nivelin qendror dhe lokal, duke u radhitur që nga asistenca emergjente, qasja në shërbimet publike dhe ndihma e mbështetja sipas nevojës, me qëllim që kthimi të jetë i qëndrueshëm.

VIII.1. Programi për Riintegrim

Duke u mbështetur në politikat Qeveritare dhe vizionin për të përmirësuar jetën e qytetarëve të Kosovës në aspektin socio-ekonomik, Qeveria siguron programin e riintegritit për ndihmën dhe mbështetjen e personave të riatdhesuar gjatë procesit të riintegritit.

VIII 1.1. Qëndrueshmëria dhe mobilizimi social

Programi i riintegritit përfshin zhvillimin si proces i gjerë multi-sektorial për të arritur dhe për të forcuar vizionin e shprehur në këtë strategji. Në frymën e parimit të mos diskriminimit me qëllim që të mos nxitë përjashtimin dhe varfërinë, nevojiten që politikat gjithëpërfshirëse për të adresuar krijimin e politikave sociale të cilat veprojnë mbi parimin e barazisë me rastin e zhvillimit të politikave sektoriale dhe shpërndarjes së mjeteve nga programi, si strehimi dhe kushtet e jetesës, çështjet e shëndetësisë, arsimit, trajnimit profesional dhe punësimit, si në aspektet gjinore ashtu edhe etnike. Gjithashtu, nevojitet që mobilizimi social i mbështetur përmes mjeteve të qëndrueshme institucionale të bëhet në bashkëpunim me shoqërinë civile.

VIII 1.2. Decentralizimi i kompetencave

Në mënyrë që të ndjekim vizionin e kësaj strategjie dhe për të jetësuar programin e riintegritit, Qeveria ka vendosur të decentralizojë pushtetin dhe burimet në nivelin lokal dhe t'ua japë komuniteteve qasjen dhe ndikimin për çështjet që prekin jetën e përditshme të tyre. Ajo përfaqëson bartjen administrative të pushtetit dhe burimeve dhe fuqizimin e nivelit komunal për përballje me kompetencat e riintegritit.

Pjesëmarrja efektive e komuniteteve kuptohet si një proces i qeverisjes lokale dhe konsiderohet si tregues i rëndësishëm zhvillimi, e cila do të jetë pjesë e vlerësimeve objektive dhe subjektive të mirëqenies sociale.

Decentralizimi i mëtejshëm i kompetencave do të bëhet në mënyrë graduale, hap pas hapi, me qëllim që mos të rrezikohet procesi i mbështetjes dhe ndihmës së personave të riatdhesuar. Fillimisht gjatë vitit 2014 do të funksionalizohen dhe fuqizohen kapacitetet komunale, si burimet njerëzore ashtu edhe ato teknike, dhe do të bëhet analiza e nevojave buxhetore komunale, për të vazhduar pastaj me delegimin e kompetencave në tri pilot komuna gjatë vitit 2015. Pas vlerësimit dhe bartjes së praktikave më të mira nga tri pilot komunat gjatë vitit 2016 do të bëhet bartja e kompetencave në të gjitha komunat e Kosovës. Gjatë gjithë procesit të decentralizimit, komunat do të mbështeten nga organet e nivelit qendror.

VIII 1.3. Aktivitetet dhe iniciativat

Për të përmirësuar këtë proces të qeverisjes lokale duhet të merren parasysh:

- Politikat sociale qendrore dhe lokale që mundësojnë personave të riatdhesuar për forcimin e fuqisë negociuese, si grup në gjendje të ndjeshme.
- Legjislacioni relevant përfshirë aktet nën-ligjore për përcaktimin e kompetencave të autoriteteve vendimmarrëse dhe përfitimeve, për vendosjen e linjave raportuese dhe sigurinë ligjore për secilin vendimmarrës të përfshirë në procesin e riintegritit.

- Përgatitja e procedurave standarde operative dhe e udhëzuesëve për zbatimin e politikave, në bazë të legjislacionit që do të mundësoj qasjen e barabartë të pjesëmarrjes së komuniteteve në politikat dhe procedurat të cilat aplikohen.
- Krijimi i një mekanizmi që siguron shmangien e konflikteve përmes bashkëpunimit dhe koordinimit efektiv në mes të gjitha institucioneve publike të përfshira, që do të realizoj takime të rregulta për këmbimin e informative në mes të zyrtarëve të nivelit qendror dhe lokal, si dhe niveleve të ndryshme të menaxhmentit.
- Funksionalizimi i sistemit për menaxhimin e rasteve.
- Këshillimi dhe informimi me qëllim të vetdijesimit për rregullat dhe ndryshimet.
- Vlerësimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i cili duhet të përkufizohet dhe strukturohet ku përfshihen qëllimet, synimet dhe indikatorët.

VIII.1.4. Mbështetja dhe ndihma

Nga programi i riintegrimin ofrohet mbështetja dhe ndihma e personave të riatdhesuar në nivelin qendror dhe lokal.

Ndihma e ofruar në nivelin qendror përfshinë:

- Ndihmën menjëherë pas arritjes;
- Transportin deri në vendin e destinacionit;
- Akomodimin e përkohshëm.

Ndihma e ofruar në nivelin lokal përfshinë:

Në nivelin lokal, ndihma dhe mbështetja e ofruar për personat e riatdhesuar kryesisht organizohet si pjesë e shërbimeve komunale në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me autoritetet lokale të mirëqenjes sociale, shëndetësisë, punësimit, arsimit(arsimimit), banimit dhe ofruesëve tjerë të shërbimeve publike.

Ndihma dhe mbështetja në nivelin lokal ndahen në dy kategori:

- Ndihma dhe mbështetja përmes shërbimeve publike;
- Ndihma dhe mbështetja përmes parashtrimit të kërkesave.

ZKKK-të kanë rol kyç në garantimin që të riatdhesuarit të kenë qasje në ndihmën dhe mbështetjen e personave të riatdhesuar gjatë procesit të riintegrimin.

Ndihma dhe mbështetja përmes shërbimeve publike mbulon fushat si në vijim:

- Regjistrimi civil;
- Pajisja me dokumente personale;
- Sigurimi i banimit;
- Trajtimi shëndetësor;
- Mirëqenia sociale;
- Punësimi dhe aftësimi profesional;
- Arsimi dhe mësimi plotësues;
- Trajtimi psiko-social në rast nevojë.

Ndihma dhe mbështetja përmes parashtrimit të kërkesave mbulojnë fushat si në vijim:

- Pakoja ushqimore dhe higjienike;
- Pakoja e ndihmës për dimër;
- Pakoja e orendive;
- Ndihma e rastit;
- Banimi përmes qirasë;
- Trajtimi mjekësor;
- Renovimi/rindërtimi i shtëpive;

- Ndhimja për vetëpunësim/themelimi biznesi.

VIII.2. Fondi për Riintegrim

Fondi i Riintegrimit është krijuar për zbatimin e Programit të Riintegrimit. Disbursimi i fondeve të mjaftueshme është me rëndësi vitale në mënyrë që të sigurohet se iniciativat do t'u përgjigjen në mënyrë të mirëfilltë kërkesave dhe nevojave të personave të riatdhesuar në fushat me prioritet, siç janë identifikuar në strategji dhe përcaktuar në kuadër të kornizës ligjore dhe administrative. Qëllimi i fondit është që të mbështeten personat e riatdhesuar për rivendosje dhe riintegrim në shoqërinë e Kosovës. Përfitimet nga fondi synojnë në sigurimin e shërbimeve dhe ndihmës për të gjithë personat e riatdhesuar, pa dallim në bazë të përkatësisë etnike, fetare dhe gjinore.

Derisa Qeveria ka vendosur për të bartur pushtetin administrativ, resurset dhe buxheti do të planifikohet në buxhetet vjetore të komunave. Programet për bartjen e parasë nuk janë pa probleme. Caktimi i nevojave kërkon shqyrtim të kujdesshëm dhe është me rëndësi që të sigurohen burime të qëndrueshëm financiare për politikën sociale.

Caktimi i nevojave duhet të shihet si një instrument për mbulimin e shërbimeve themelore e jo si zëvendësim për jetesën e përgjithshme. Për qëllime të riintegrimit kjo kërkon një pikëpamje multi-sektoriale dhe të tërësishme të gjithë procesit, e që komunat nuk mund ta arrijnë për shkak të shtrirjes gjeografike. Prandaj Fondi është i vendosur në nivelin qendror dhe mjetet financiare do të sigurohen si pjesë e buxhetit shtetëror.

VIII 2.1. Mbulesa financiare

Me qëllim të arritjes së objektivave të riintegrimit të qëndrueshëm, Qeveria ka ndarë fonde për riintegrimin e qytetarëve të riatdhesuar të Kosovës:

- 2010: 500.000,- Euro
- 2011: 3,420.150,- Euro
- 2012: 3,170.000,- Euro
- 2013: 3,170.000,- Euro

E njëjta shumë si në dy vitet e fundit 2012 dhe 2013 do të ndahet për MPB-në edhe në vitet e ardhshme për kohëzgjatjen e Planit të Veprimit të rishikuar. Në mënyrë që të arrihet efekti i dëshiruar, programi si mjet strategjik i intervenimeve sociale të Qeverisë varet jo vetëm nga shumica e burimeve e dedikuara për ta, por edhe nga ajo se si ndahen dhe menaxhohen këto burime.

VIII 2.2. Menaxhimi i Fondit

Qëllimi i Fondit është që të shërbejë si program i transferit social. Ofrimi i shërbimeve dhe asistencës për përfituesit do të bëhet nga organet vendimmarrëse siç përcaktohet në legjislacionin relevant (administratë e decentralizuar), çka nënkupton që komunat duhet të financojnë shërbimet e tyre që do t'i afrojnë pas periudhës 12 mujore deri në transferin e plotë të kompetencave. Plani i Veprimit përcakton edhe procesin e mirëfilltë të rrjedhës së parasë përfshirë standardizimin e mekanizmave të komunikimit dhe kontrollit për fondet e ndara.

Buxheti i Fondit menaxhohet nga MPB i cili sigurohet në baza vjetore si pjesë e buxhetit shtetëror dhe mund të variojë në bazë të zhvillimeve dhe trendeve të cilat duhet të vlerësohen dhe analizohen rregullisht. Menaxhimi përfshin përgjegjësinë e përgjithshme për mjetet financiare dhe disbursimi i tyre me konsideratë të veçantë që pjesët e Fondit mund të ndahen për ministritë relevante dhe komunat për mbështetjen e projekteve me pjesëmarrje civile si

pjesë e dimensionit të mobilizimit social. Përfituesit e projektit duhet të jenë personat e riatdhesuar.

Mjetet financiare duhet të jepen përmes përfitimeve dhe ndihmës për personat e riatdhesuar, gjë që kërkon legjislacion të qartë, sidomos në kuptimin e definicioneve, procedurave, vlerësimit të nevojave, shumave maksimale, kufirit të shpenzimeve si edhe ndërprerjes së ndihmës. Vlerësimi i shpenzimeve dhe proceseve duhet të bëhet në fazën fillestare të zbatimit në baza tremujore edhe në fazë të mëvonshme siç përshkruhet në Planin e Veprimit.

VIII 2.3. Sistemi i Menaxhimit të Rasteve (SMR)

Me qëllim të menaxhimit funksional të çështjeve të riintegrimin të cilat synojnë në arritjen e objektivave të përcaktuara nga Strategjia, Qeveria ka vendosur të lansojë Sistemin për Menaxhimin e Rasteve, si mjet kryesor drejtues për menaxhimin e Programit dhe Fondit të Riintegrimin.

Aktivitetet e strukturuar dhe të planifikuara për mbështetjen e personave të riatdhesuar në secilin rast krijojnë bazën për menaxhimin e Programit të Riintegrimin në aspektin e tij vizionar dhe strategjik. Për këtë arsye është e rëndësishme të përcaktohen qartë korniza normative, organizative dhe operative për aplikimin e mirëfilltë të Sistemit për Menaxhimin e Rasteve.

- Korniza normative: Niveli i ofrimit të shërbimit dhe përfitimeve bazohet në normat dhe kornizat ligjore dhe administrative të institucioneve publike të përfshira. Menaxhimi i rasteve funksionon në mënyrën më efektive, atëherë kur ai në mënyrë eksplicite është një element i politikave të tregut të punës dhe planifikimit social dhe i legjitimuar. Qëllimi është që të arrihet një sistem i transferit social i bazuar në nevoja për personat e riatdhesuar, çka kërkon një përkushtim të gjerë të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në Programin e Riintegrimin.
- Korniza organizative: Është e nevojshme të krijohet një mandat i qartë institucional në pajtim me strategjinë, konceptet e tjera relevante, proceset dhe mjetet, por edhe një mekanizëm për bashkëpunim dhe koordinim për shërbimet e ofruara përfshirë edhe dimensionin e jashtëm të bashkëpunimit.
- Korniza operative: Ky nivel i menaxhimit të rasteve kryesisht përqendrohet në menaxhimin e furnizimeve në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me personat e riatdhesuar, është i orientuar në praktikë dhe në mënyrë fleksibile reagon në situata të veçanta të përfituesve. Procedurat e krijuara për vlerësimin e nevojave dhe hapat e definuar procedural duhet të përkufizohen në Planin e Veprimit ose dokumentet e tjera relevante. Menaxhimi i rasteve është proces bashkëpunues në të cilin mblidhen, planifikohen, zbatohen, koordinohen, mbikëqyren dhe vlerësohen çështjet e furnizimeve dhe shërbimeve sociale në mënyrë që të sigurohet se janë plotësuar nevojat e mbështetjes individuale në kuadër të sistemit ekzistues, burimeve dhe mjeteve të komunikimit.

Sistemi për Menaxhimin e Rasteve është sistem elektronik i cili administrohet nga MPB në të cilin regjistrohen, ruhen, procedohen dhe arkivohen kërkesat dhe të dhënat e tjera relevante lidhur me personat e riatdhesuar dhe përfitimet e tyre. Përmes SMR-së menaxhohet në tërësi procesi i riintegrimin të personave të riatdhesuar nga momenti i hyrjes në Kosovë deri në mbylljen e rastit, sipas procedurave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Të dhënat e personave të riatdhesuar trajtohen në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

SMR-ja synon të:

- Siguroj që secili rast individual procedohet në mënyrë të shpejtë, efektive dhe efikase.

- Siguroj transparencë në menaxhimin e fondit.
- Siguroj një bazë të të dhënave të unifikuar dhe të përbashkët.
- Siguroj koordinimin dhe lehtësimin e bashkëpunimit ndërmjet palëve të interesit.
- Standardizoj linjat vertikale e horizontale dhe procedurat e komunikimit.
- Promovoj koordinimin dhe bashkëpunimin me palët ndërkombëtare dhe shoqërinë civile.

Menaxhimi i rasteve është proces bashkëpunues në të cilin mblidhen, planifikohen, zbatohen, koordinohen, mbikëqyren dhe vlerësohen çështjet e furnizimeve dhe shërbimeve sociale në mënyrë që të sigurohet se janë plotësuar nevojat e mbështetjes individuale në kuadër të sistemit ekzistues, burimeve dhe mjeteve të komunikimit.

Sistemi i të dhënave shërben për regjistrimin e shpenzimeve në përputhje me Programin dhe Fondin e Riintegrimit. Qëllimi është që sistemi të sigurojë informata të përgjithshme, të shërbejë si mekanizëm mbikëqyres dhe vlerësues për të mundësuar që aktivitetet dhe nevojat buxhetore të planifikohen më mirë dhe të përmirësohen politikatat e aplikuara.

Zbatimi i përgjithshëm i Sistemit të Menaxhimit të Rasteve kërkon një përfshirje të përqendruar të të gjitha institucioneve të definuara në të gjitha dimensionet e aktiviteteve relevante, pasi që është një kombinim i menaxhimit të rasteve dhe sistemit. Ai përfshin jo vetëm nivelin institucional të ofrimit të shërbimeve dhe përfitimeve, por edhe nivelin e punës së drejtpërdrejtë me personat e riatdhesuar.

Zbatimi i tij do të shtoj efikasitetin dhe efektivitetin e politikave të aplikueshme sociale në përgjithësi dhe do të sigurojë që secili rast individual i riintegrimit procesohet në mënyrë efikase dhe efektive. Ai do të sigurojë transparencë të menaxhimit të fondit dhe do të lehtësojë bashkëpunimin në të gjitha nivelet.

Kapitulli IX. Monitorimi dhe Vlerësimi

Procesi i zbatimit të *Strategjisë së Riintegrimit* do të jetë proces i arritjes së objektivave strategjike, specifike dhe aktiviteteve përkatëse. Monitorimi dhe vlerësimi do të shërbejnë për të përcjellë zbatimin e *Strategjisë së Riintegrimit*, për të matur nivelin e zbatimit të objektivave të saj, sidomos zbatimin e aktiviteteve të caktuara në proces.

Monitorimi dhe vlerësimi do të bazohet në indikatorët e identifikuar në *Strategjinë për Riintegrim* dhe në *Planin e Veprimit*, përfshirë angazhimet me palët e jashtme dhe të brendshme të interesit, siguron rekomandimet dhe afatet kohore për përmirësimin e politikave, siguron fleksibilitet për zhvillimet e mundshme të jashtme dhe të brendshme, si dhe intervenime strategjike për t'i adresuar ato.

IX.1. Strukturat institucionale për monitorim dhe vlerësim

Për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të *Strategjisë së Riintegrimit* do të përgatitet plani i monitorimit i cili ka të bëjë me monitorimin dhe vlerësimin e jashtëm dhe të brendshëm të *Strategjisë së Riintegrimit* dhe *Planit të Veprimit*, dhe i mbulon aspektet kuantitative dhe kualitative, duke siguruar monitorimin dhe vlerësimin e përmbajtjes së veprimeve të planifikuara dhe monitorimin financiar të zbatimit (auditimi).

Si mjet për monitorim dhe vlerësim do të shërbej Sistemi për Menaxhimin e Rasteve, i cili do të përditësohet me të dhëna, nga të gjithë akterët relevantë, gjatë zbatimit të kësaj strategjie.

Plani për monitorim dhe vlerësim përshkruan detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të interesit, të cilat janë të përfshira në arritjen e objektivave dhe në aktivitetet e zbatimit të caktuara në Strategjinë për Riintegrim dhe në Planin e Veprimit.

MPB është autoriteti kryesor përgjegjës për koordinimin dhe zbatimin e monitorimit dhe vlerësimit të brendshëm me qëllim të sigurimit të mekanizmit koherent dhe të integruar të raportimit. Palët e tjera të interesit, në nivelin qeveritar dhe lokal, i vejnë në dispozicion të dhënat dhe informatat e nevojshme, dhe përgatisin raporte të rregullta monitorimi për progresin e tyre. Raportet e rregullta të monitorimit bëhen përmes formës standarde të raportimit të elaboruar nga MPB/DRPR. Organizatat joqeveritare do të marrin pjesë në monitorimin dhe vlerësimin e strategjisë në tryezat e përbashkëta të cilat do të organizohen rregullisht nga DRPR.

IX.2. Mekanizmat raportues

Monitorimi dhe vlerësimi i brendshëm (përfshirë auditimin) duhet të procedohen në pajtim me kornizën legjislative ekzistuese. Raportet e progresit dërgohen rregullisht nga palët e interesit në nivelin qendror dhe lokal tek MPB në fazat fillestare dhe në fazat e mëvonshme siç përshkruhet në Planin e Veprimit. Monitorimi dhe vlerësimi i jashtëm bëhet çdo vit për të vlerësuar objektivat dhe synimet e arritura me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të zbatimit të Strategjisë për Riintegrim.

IX.3. Identifikimi i indikatorëve

Monitorimi dhe vlerësimi realizohet në bazë të sistemit koherent të indikatorëve të kontributit efektiv, rezultatit, produktit dhe ndikimit, të cilët do të identifikohen në Planin e Veprimit për veprimet specifike të cilat synojnë në arritjen e objektivave të Strategjisë për Riintegrim.

Indikatorët identifikohen me qëllim që të dëshmojnë ndikimin e Strategjisë për Riintegrimin e personave të riatdhesuar në jetën sociale dhe ekonomike të Kosovës, që synojnë në një sistem të qëndrueshëm të riintegrimin të personave të riatdhesuar, dhe në ngritjen e vetëdijes për qëllimin e përgjithshëm të Strategjisë për Riintegrim.

IX.4. Shpërndarja e rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit

Shpërndarja e rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit do të bëhet në pajtim me Planin për monitorim dhe vlerësim të të gjithë akterëve relevant.

Kapitulli X - Ngritja e vetëdijes dhe fushatat e informimit

Dukuria e migrimit të parregullt më së shumti lidhet me trafikimin e qenieve njerëzore dhe me kontrabandimin me njerëz dhe në mesin e krimeve transnacionale është një kërcënim serioz për përceptimin e Kosovës dhe rajonit në tërësi.

Për këtë arsye, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) do të sigurojë një fushatë publike që në mënyrë gjithëpërfshirëse të informojë të gjithë qytetarët lidhur me rrezikun dhe kërcënimet e migrimit të parregullt.

Objektivat kyç të nismave janë që të ofrohet informim gjithëpërfshirës dhe në kohë për të gjithë qytetarët e Kosovës në mënyrë që të ngritet vetëdija për rrezikun, kërcënimet dhe pasojat e mundshme lidhur me migrimin e parregullt dhe në të njëjtën kohë të ofrohet ndihmë drejt procedurave dhe rrugëve ligjore për migrim të rregullt (p.sh. vizita pune, grande qeveritare për studime jashtë shtetit, punësim sezonal, turizëm, etj). Po ashtu rendesi e posaçme do tu kushtohet vetëdijesimit publik dhe mobilizimit social e në veqanti informimit të personave të riatdhesuar për mundësin e mbështetjes dhe ndihmes nga programi i riintegrimin.

SHTOJCA A - DEFINICIONET

Për qëllime të kësaj Strategjie:

Ndihma - nënkupton shërbimet për mbështetjen e personave të riatdhesuar gjatë procesi të riintegrimit dhe promovimin e riintegrimit.

Përfitimet - nënkuptojnë masat për mbështetjen nga programi i riintegrimit.

Sistemi për Menaxhimin e Rasteve (SMR) - është sistem elektronik ku procedohen, ruhen dhe arkivohen informatat për personat e riatdhesuar dhe përfitimet e tyre.

Komisioni Qendror për Riintegrim (KQR) - është organi vendimmarrës i cili përbëhet nga përfaqësuesit e ministrive relevante.

Komisioni për Ankesa- nënkupton organin tek i cili mund të parashtrohet ankesa e parë kundër vendimit të lëshuar nga KQR ose KKR të referuar në këtë rregullore.

Koordinimi-nënkupton që ministritë përkatëse, autoritetet dhe akterët e tjerë e mbështesin riintegrimin në mënyrë efektive bashkë si tërësi.

Kthimi jo-vullnetar- është procesi kur një individ kthehet në Kosovë përkundër dëshirës së tij për arsye të mungesës së të drejtës së tij ligjore për të qëndruar në shtetin nikoqir, për faktin se ai ka hyrë në mënyrë ilegale, apo leje qëndrimi i ka skaduar, kërkesa për azil i është refuzuar përfundimisht. Mbrojtja ndërkombëtare i është revokuar ose është shpallur person i padëshirueshëm. Kthimi jovullnetar mund të përfshijë zbatimin e masave detyruese për zbatimin e ekzekutimit të kthimit.

Menaxhimi i riintegrimit në nivelin qendror- nënkupton veprimet e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe Departamentit për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar (DRPR).

Menaxhimi i riintegrimit në nivelin lokal - nënkupton veprimet e ndërmarra nga kryetarët e komunave, Zyrrat komunale për kthim dhe komunitete (ZKKK) dhe koordinatorët rajonalë.

Kthimi i detyrueshëm -nënkuptohet si proces ku individi vendos të kthehet në Kosovë duke qenë i vetëdijshëm se ai/ata nuk kanë të drejtë ligjore të qëndrojnë në vendin nikoqir dhe se mund t'ju nënshtrohen sanksioneve në bazë të kësaj (shihni bazat ligjore që aplikohen për kthim jo-vullnetar).

Komisioni Komunal për Riintegrim (KKR)- është organi vendimmarrës i cili përbëhet nga përfaqësuesit e shërbimeve komunale relevante.

Programi- është Programi për Riintegrim të personave të riatdhesuar i themeluar nga Qeveria.

Ripranimi -është proces i cili fillon kur Divizioni për Ripranim (DSHAM) merr njoftimin nga një shtet i tretë, i cili ka për qëllim të kthejë një individ në Kosovë dhe kërkon që autoritetet të konfirmojnë nëse individi është me origjinë nga Kosova. Divizioni për Pranim verifikon të detajet personale dhe pranon/refuzon kërkesën dhe procesi përfundon atëherë kur individi ka arritur në Kosovë dhe ka kaluar nëpër procedurat e kontrollit kufitar.

Riatdhesimi - është veprimi i kthimit në Kosovë i realizuar nga një qytetar i Kosovës apo një qytetar me origjinë nga Kosova dhe aplikohet në të gjitha llojet e kthimit në rastin kur hyrja në territorin e Kosovës bëhet përmes një pike zyrtare të kalimit kufitar.

Person i riatdhesuar - nënkupton një kosovar i cili në mungesë të bazës ligjore për qëndrim në vend të huaj është riparuar në Kosovë.

Riintegrimi - nënkupton ripërfshirjen e personave të riatdhesuar në shoqërinë e Kosovës dhe promovimin e kushteve të tyre ekonomike, sociale dhe politike në nivelin e qasjes në shërbime, në të drejta dhe mundësi të cilat janë të barabarta me qytetarët e tjerë të Kosovës.

Kthimi- nënkupton procesin e kthimit në Kosovë (vullnetar, jo-vullnetar, të detyrueshëm) si një proces i gjatë dhe kompleks që përfshin komponentë të shumtë (ripranimi, riatdhesimi, riintegrimi), në lidhje me të gjitha fushat (shëndetësi, arsimim, gjenerim i të ardhurave, etj.) dhe sferat personale, sociale, politike) të jetës së një individi dhe përfundon atëherë kur individi e arrin statusin e barabartë me të gjithë qytetarët e Kosovës sa i përket qasjes në të drejta dhe mundësi.

I kthyeri - është një person me origjinë nga Kosova i cili kthehet në Kosovë.

Kthimi vullnetar - është një proces ku individi vendos të kthehet vullnetarisht në Kosovë.

Grupet e cenueshëm - nënkupton personat e riatdhesuar të cilët kanë nevojë për masa të veçanta të riintegrimin si pasojë e kapacitetit të tyre të zvogëluar funksional, për shkak të sëmundjes apo aftësive të kufizuara, apo si pasojë e gjendjes së tyre familjare, gjinisë, moshës, analfabetizmit apo arsyeve të ngjashme, ose personat të cilëve u mungojnë njohuritë adekuate të gjuhëve zyrtare të Kosovës.

SHTOJCA B - KORNIZA LIGJORE PËR RI-INTEGRIM

I. Republika e Kosovës ka një bazë të gjerë ligjore në fushën e Ri-integrimit si legjislacion primar mund të përmendet por nuk kufizohet në legjislacionin si në vijim:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës,
- Ligji nr.04/L-215 për Shtetasin e Kosovës,
- Ligji nr.04/L-217 për Azil,
- Ligji nr.04/L-219 për te Huajt,
- Ligji nr. 03/L-208 për Ripranim,
- Ligji nr.04/L-003 për Gjendjen Civile,
- Ligji nr.02/L-121 për Vendbanimin dhe vendqëndrimin,
- Ligji nr.02/L-118 për Emrin Personal,
- Ligji nr.03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale,
- Ligji nr.03/L-099 për Letërnjoftim,
- Ligji nr.04/L-126 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr 03/L-099 për Letërnjoftim,
- Ligji nr.03/L-154 për Pronësinë dhe të drejtat tjera sendore,
- Ligji nr.03/164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimi,
- Ligji nr.2003/13 mbi Ndryshimet dhe Plotesimet e Ligjit nr.2002/5 mbi themelimin e Regjistrimit të të drejtave në Pronën e Paluajtshme,
- Ligji nr.03/L-079 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për Zgjidhjen e Kërkesave Lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale,
- Ligji nr.03/L-237 për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave,
- Ligji nr. 04/L-125 për Shëndetësi,
- Ligji nr. 02/L-50 për Kujdesin Shëndetësor Emergjent,
- Ligji nr.04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë,
- Ligji nr. 03/L-212 i Punës,
- Ligji nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve,Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të Tyre,
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës,
- Kodi i Procedurës Penale,
- Ligji nr.2003/23 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë,
- Ligji nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës,
- Ligji nr.04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/l-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare,
- Ligji nr. 02/L-52 mbi Edukimin Parashkollor,
- Ligji nr. 02/L-78 për Shëndetësi Publike,
- Ligji nr. 04/L-095 për Diasporën dhe Mërgatën
- Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës,
- Ligji nr.2004/37 për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë,

- Ligji nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës,
- Ligji nr. 02/L-42 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional,

II. Si legjislacion sekondar për Ri-integrim janë aktet por nuk kufizohet si ne vijim:

- Rregullorja QRK Nr.20/2013 për Ri-integrimin e personave të Riatdhesuar dhe Menaxhimin e Ri-integrimit,
- Udhëzimi Administrativ nr.11/2004 për Punën dhe Kriteret e Vendosijes se Rezidenteve ne Shtepine e Personave te Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare,
- Udhëzimi Administrativ nr.12/2004 për Punën dhe Vendosijen e Rezidenteve ne Institucionin Special në Shtime,
- Udhëzimi Administrativ nr.09/2011 për Zbatimin e ligjit për Ripranim,
- Udhëzimi Administrativ Nr.18/2010 për Përmbajtjen e kontratës për banesat me qira joprofitabile,
- Udhëzimi Administrativ Nr. 19/2010 për Përmbajtjen e bonusit të banimit,
- Udhëzimi Administrativ Nr.21/2010 për Kriteret e përcaktimit të radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet,
- Udhëzimi Administrativ Nr.22/2010 për Procedurat për përfitimin nga programet e veçanta të banimit,
- Udhëzimi Administrativ Nr.23/2010 për Procedurat për shpalljen e programeve e veçanta të banimit,
- Udhëzimi Administrativ Nr.24/2010 për Normat minimale të banimit për banesat e programeve të veçanta të veçanta të banimit,
- Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2012 për Regjistrimet e me vonshme ne Regjistrat e Gjendjes Civile,
- Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2012 për Riregjistrim ne Regjistrat themeltar te gjendjes Civile,
- Udhëzimi Administrativ nr.17/2010 Përcaktimi i kushteve dhe procedurave në përmbushjen e strategjisë për riintegrimin e personave te riatdhesuar.
- Udhëzimi administrativ për arsim nga MASHT,
- Udhëzimi administrativ nr.16/2003 regjistrimi i nxënësve ne vitin e 10 te ardhur nga vendet tjera,
- Udhëzimi administrativ 1/2004 Barasvlera dhe Nostrifikimi idokumentave te Arsimit fillor dhe Arsimit te Mesëm te Ulet te marra ne shtet jashtë Kosovës,
- Udhëzimi administrativ 50/2007 zbatimi i kurrikulit te shkollës shqipe te mësimi plotësues ne diaspore.

III. Gjithashtu ekzistojnë edhe strategji qe e trajtojne qeshtjen e Ri-integrimit:

- Strategjia e Rishikuar për Ri-integrimin e personave te Riatdhesuar, dhe plani i veprimit,
- Strategjia për RAE,
- Strategjia për Komunitete dhe Kthim,

- Strategjia kombëtare për Migracion,
- Strategjia Nacionale Kundër trafikimit me qenie njerëzore,
- Strategjia Shëndetësore e Kosovës,
- Strategjia në Parandalimin e Incidenteve në Shkollë.

IV. Konventat dhe aktet ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Kosovës, që kanë ndikim në mbrojtjen e personave të riintegruar janë:

- Deklaratën Universale mbi të Drejtat e Njeriut,
- Konventa e Gjenevës mbi Mbrojtjen e Refugjatëve, 1951; dhe Protokollin e 1967,
- Konventa e Nju Jorkut për Personat Pa Shtetësi,
- Konventa e OKB-së për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Gruas,
- Konventa e OKB-së Kundër Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Tjetër Mizor, Jorhuman dhe Poshtëruar, 1984,
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollin e saj,
- Konventa e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijës,
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollin e saj.